



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosova

MANUAL PËR REGJISTRIM NË KONFERENCËN E 7-TË NDËRKOMBËTARE TË STOMATOLOGJISË (17-18 PRILL 2026)

për përdoruesit e jashtëm (jo anëtarë të OSK-së)

Regjistrimi për përdoruesit e jashtëm (jo anëtarë të OSK-së) realizohet përmes platformës digjitale, në opsionin e përdoruesit të jashtëm.

Ai shërben vetëm për qëllime të mundësimit të qasjes në modulën e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, për regjistrim në Konferencën e 7-të Ndërkombëtare të Stomatologjisë dhe për administrimin e pjesëmarrjes në të.

Pas përfundimit të aktivitetit, certifikata për pjesëmarrje do të dërgohet në adresën elektronike të përdoruesit, sipas të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit.

Si bëhet regjistrimi?

Për t'u regjistruar, fillimisht duhet të hapni platformën në adresën **online.osk-ks.org**. Në faqen hyrëse, duhet të zgjidhni opsionin **“Apliko si individ i jashtëm”**. Ky është hapi i parë për krijimin e qasjes në platformë. Për më shumë, shih foton përkatëse.

The screenshot shows the login interface of the online.osk-ks.org platform. At the top right, there are language selection links: AL, EN, SR. In the center, there is a circular logo of the Kosovo Dental Association (Kosovska Stomatološka Komora) with the text 'Platforma digjitale për shërbimet e OSK-së' below it. The main heading is 'Kyçu' (Login). Below this, there are two input fields: 'Email adresa' with the placeholder 'p.sh. email@domain.com' and 'Fjalëkalimi' (Password) with a masked input '*****' and a toggle icon. A link 'Keni harruar fjalëkalimin?' is located below the password field. A blue 'Identifikohu' button is positioned below the inputs. At the bottom, there are three links: 'APLIKO PËR ANËTARËSIM NË OSK', 'APLIKO SI ORGANIZATË APO INDIVID I JASHTËM' (which is circled in red), and 'PËRDITËSONI TË DHËNAT TUAJA'. An annotation box on the right states: 'Adresa e platformës online është: online.osk-ks.org.' Another annotation box on the right states: 'Nëse nuk jeni anëtar i OSK-së, por jeni teknik i stomatologjisë, asistent dentar ose profesionist shëndetësor nga shtete të tjera, klikoni këtu për t'u regjistruar si përdorues i jashtëm në platformën e OSK-së, pa obligime anëtarësie.' An arrow points from this second annotation box to the red-circled link.

AL EN SR

Platforma digjitale për shërbimet e OSK-së

Kyçu

Email adresa

p.sh. email@domain.com

Fjalëkalimi

[Keni harruar fjalëkalimin?](#)

[Identifikohu](#)

[APLIKO PËR ANËTARËSIM NË OSK](#)

[APLIKO SI ORGANIZATË APO INDIVID I JASHTËM](#)

[PËRDITËSONI TË DHËNAT TUAJA](#)

Adresa e platformës online është:
online.osk-ks.org.

Nëse nuk jeni anëtar i OSK-së, por jeni teknik i stomatologjisë, asistent dentar ose profesionist shëndetësor nga shtete të tjera, klikoni këtu për t'u regjistruar si përdorues i jashtëm në platformën e OSK-së, pa obligime anëtarësie.

Pasi të keni zgjedhur këtë opsion, do të hapet një faqe e re ku kërkohet plotësimi i të dhënave personale. Është shumë e rëndësishme që këto të dhëna të plotësohen me kujdes dhe saktësi, sepse ato do të përdoren jo vetëm për regjistrimin tuaj në aktivitetet e EVP-së, por edhe për lëshimin e certifikatës në fund të aktivitetit. Për më shumë, shih foton përkatëse.

The screenshot shows a web form titled 'Personal data' for registration. It includes fields for personal information, contact details, and document uploads. Red annotations highlight specific parts of the form:

- Apiko si individ**: A red box with an arrow pointing to the 'Individ' radio button under 'Apiko si'.
- Plotësoni të dhënat tuaja të tjera personale**: A red box with an arrow pointing to the 'Emri' (Name) field.
- Ngarkoni licencën tuaj të punës ose diplomën universitare**: A red box with an arrow pointing to the 'Dokumentet mbështetëse' (Supporting documents) upload section.

The form fields include:

- Personal data**: ☒ Personal data, ☐ Organizatë, ☒ Individ
- Emri ***: p.sh. Filan
- Mbiemri ***: p.sh. Fiste
- Profesioni**: p.sh. Infermier
- Gjinia ***: Zgjedh gjininë
- Statusi martesor ***: Zgjedh statusin martesor
- Emri i babait ***: p.sh. Filan
- Numri personal ***: p.sh. 1234567890
- Data e lindjes ***: p.sh. 02.03.1986
- Vendlindja ***: p.sh. Prishtinë
- Komuna e lindjes ***: Zgjedh komunën
- Adresa aktuale e vendbanimit ***: p.sh. Rruga Shembull 23
- Komuna e vendbanimit ***: Zgjedh komunën
- Nacionaliteti ***: Zgjedh nacionalitetin
- Shtetësia ***: Prishtinë
- Numri i telefonit mobil ***: p.sh. 044111222
- Email adresa ***: p.sh. email@domain.com
- Fotografia**: Ngarko
- Letërnjoftimi (valid) (.jpg, .jpeg, .png, .pdf) ***: Choose File, no file selected
- Dokumentet mbështetëse (.jpg, .jpeg, .png, .pdf)**: Choose File, no file selected

Buttons at the bottom: **Mëparshëm** and **Vijues**.

Pas plotësimit të të dhënave dhe shtypjes së butonit **“Vijues”**, sistemi do t’ju paraqesë një përmbledhje të të dhënave të regjistruara. Në këtë fazë, ju lutemi që t’i verifikoni edhe një herë me kujdes të gjitha informatat. Nëse vëreni ndonjë pasaktësi, mund të ktheheni mbrapa përmes butonit **“Mëparshëm”** dhe të bëni korrigjimet e nevojshme. Nëse të dhënat janë të sakta, duhet të shënoni deklaratën përkatëse dhe më pas të klikoni butonin **“Regjistrohu”**.

AL EN SR

1 Personal data

Plotësoni regjistrimin

Konfirmoni të dhënat tuaja të plotësuara paraprakisht, nëse janë të sakta, për të vazhduar me hapin e radhës.

Shtetësia	Emri	Mbiemri	Profesioni	Gjinia
Statusi martesor	Emri i babait	Numri personal	Data e lindjes	Vendlindja
Komuna e lindjes	Adresa aktuale e vendbanimit	Komuna e vendbanimit	Nacionaliteti	Numri i telefonit mobil
Email adresa	Fotografia	Letërnjoftimi (valid)	Dokumentet mbështetëse	
		at 20.00.09.png	at 20.00.09.png	

Deklaratë

Unë, i nënshkruari me të dhënat personale, plotësoj këtë formular për të përbushur detyrimin ligjor për regjistrim si anëtar i jashtëm në platformën elektronike në Odën e Stomatologëve të Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, deklaroj nën përgjegjësi të civile dhe penale të mia se të dhënat e regjistruara më lart janë autentike dhe se unë jam përgjegjës personalisht për të dhënë një deklaratë të tillë.

☒ E kam lexuar dhe e pranoj

Shtyp tikon

Mëparshëm

Regjistrohu

Pasi ta keni shënuar tikon në butonin "E kam lexuar dhe e pranoj", shtypni butonin "Regjistrohu"

Pas përfundimit të këtij procesi, në adresën elektronike me të cilën jeni regjistruar do të pranoni një email konfirmues për aplikimin tuaj në platformë. Ky email përmban të dhënat fillestare të qasjes, përkatësisht adresën elektronike të përdoruesit dhe fjalëkalimin. Fjalëkalimin e pranuar mund ta ndryshoni gjatë kyçjes së parë në sistem. Për më shumë, shih foton përkatëse.



Më pas, pasi regjistrimi juaj të shqyrtohet dhe të miratohet nga administratori i platformës, do të pranoni një njoftim tjetër në email përmes të cilit konfirmohet miratimi i regjistrimit tuaj. Pas pranimit të këtij emaili, ju tashmë do të mund ta përdorni platformën lidhur me regjistrimin për pjesëmarrje në Konferencë. Për më shumë, shih foton përkatëse.



I/E nderuar _____


Oda e Stomatologëve të Kosovës pas vlerësimit të aplikacionit tuaj dhe dokumenteve përcjellëse, ka miratuar regjistrimin tuaj si përdorues i jashtëm në platformë.

Për çdo informacion shtesë mund të na shkruani në: odastomatologjike@gmail.com

Me respekt,
Oda e Stomatologëve të Kosovës


Ky është email i automatizuar, ju lutemi të mos ktheni përgjigje në këtë email.

Nga momenti kur e pranoni konfirmimin e regjistrimit, mund të filloni përdorimin e platformës duke u kyçur me emailin dhe fjalëkalimin që keni pranuar gjatë aplikimit.




Si aplikohet për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së?


Pasi të jeni qasur në platformë, duhet të hyni te moduli “Edukimi i Vazhdueshëm” dhe më pas të klikoni opsionin “Apliko për pjesëmarrje”. Për më shumë, shih foton përkatëse.



Pas kësaj, ju duhet të klikoni butonin “Apliko” pranë aktivitetit Konferenca e 7-të Ndërkombëtare e Stomatologjisë. Për më shumë, shih foton përkatëse.



Pasi të klikoni butonin “Apliko”, sistemi do t’ju kërkojë konfirmim përmes pyetjes nëse jeni të sigurt që dëshironi të merrni pjesë në atë aktivitet. Për të vazhduar, duhet të shtypni “Po”. Për më shumë, shih foton përkatëse.



Pas këtij veprimi, në emailin tuaj do të dërgohet një njoftim përmes të cilit konfirmohet kërkesa juaj për pjesëmarrje. Në të njëjtin email do t'i pranoni edhe të dhënat bankare për realizimin e pagesës, si dhe adresën elektronike ku duhet të dërgohet dëshmia e pagesës. Për më shumë, shih foton përkatëse.



I/E nderuar _____

Kërkesa juaj për regjistrim të pjesëmarrjes në aktivitetin e EVP-së Konferenca e 7-të Ndërkombëtare e Stomatologjisë është pranuar.

Ju lutem që në llogarinë banakare të organizatorit të aktivitetit 1701001600081756 të bëni pagesën e pjesëmarrjes në shumën 30 Euro.

Dëshmia e pagesës dërgohet në emailin zyrtar të organizatorit odastomatologjike@gmail.com

Pas pranimit të dëshmisë të pagesës, organizatori do të shqyrtojë kërkesën për regjistrim.

Me respekt,
Organizatori i aktivitetit

Ky është email i automatizuar, ju lutemi të mos ktheni përgjigje në këtë email.

Pasi ta keni kryer pagesën dhe ta keni dërguar dëshminë e pagesës në emailin e Odës, administrata do ta finalizojë regjistrimin tuaj për pjesëmarrje në konferencë.

Konfirmimi i këtij regjistrimi do t'ju dërgohet përsëri me email. Për më shumë, shih foton përkatëse.

Konfirmim i pranimi të kërkesës për pjesëmarrje në Konferenca e 7-të Ndërkombëtare e Stomatologjisë

Inbox x

🔍 🖨️ 📧



noreply@osk-ks.org
to me ▾

20:51 (0 minutes ago)



Emaili konfirmues përmes të cilit njoftoheni se organizatori i aktivitetit tuaj ju ka regjistruar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të EVP-së.

Njoftim për vendimin e ngjarjes

I/e nderuar, _____

Kërkesa juaj për regjistrim të pjesëmarrjes në aktivitetin e EVP-së "Konferenca e 7-të Ndërkombëtare e Stomatologjisë" është aprovuar.

Me respekt,
Organizatori i aktivitetit

Me pranimin e këtij emaili të fundit, regjistrimi juaj për pjesëmarrje në konferencë konsiderohet i përfunduar.

Njoftim i rëndësishëm

Ju lutemi të keni parasysh se vetëm regjistrimet e realizuara përmes platformës online të OSK-së do të konsiderohen valide për pjesëmarrje në konferencë. Prandaj, është e rëndësishme që të ndiqen me kujdes të gjithë hapat e përshkruar më sipër.